



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës**  
**Pristina Obstina-Municipality of Pristina**  
**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**



Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "WealthWave LLC" të datës 14.04.2026 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II" me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "WealthWave LLC" të datës 14.04.2026 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II" me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "WealthWave LLC" (tutje "parashtruesi") me datë 07.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot I-II" me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal I Prishtinës saktësisht njesia kërkuese nuk ka harmonizuar buxheti në bazë të kërkesave të dosjës së tenderit dhe njoftimi për kontratë. Vlera e Parashikuar për këtë aktivitet të Prokurimit nga kuvendi komunal është 2,640,000.00 € LOT I , dhe 1,344,000.00 LOT II në bazë të analizë sonë vetëm për paga e tejkalon vlerën e parashikuar pa llogaritur shpenzimet tjera të parapar në dosjen e tenderit. Shpenzimet totale sipas analizës sone financiare jan e per LOT I = **Kosto per 32 muaj, siipas vendimit Nr. 10/ 273- 3,057,861.44€. dhe Kosto per 32 muaj, siipas vendimit Nr. 10/ 273 : 1,559,714.56€** Buxheti I ndarra është në kundërshtim me kërkesat e autoriteti kontraktues, dhe në kundërshtim me ligjin e pages minimale dhe ligjtt të punës.

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit në bazë të dosjës së tenderit dhe kërkesave dhe ligjit të pages minimale I duhen buxhet shtesë në bazë të analizë sonë për LOT I dhe LOT II vetëm për mbulimin e pagave buxheti I cili duhet të ndahet është si ne vijim:

$3,057,861.44 + 1,559.714.56 = 4,617,576.00€$  për 32 muaj

#### IV. KËRKESAT

- Largimi i kriterëve diskriminuese

- Rishikimi i buxhetit

- Zgjatje afati për dorëzimin e ofertave ose Anulimin e kësaj procedure te prokurimit dhe rishikimi i buxhetit dhe kriterëve te dosjes se tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka inicuar procedure e prokurimit për Shërbimet e Pastrimit të brendshëm

dhe fare nuk ndikon që automjeti furgon të jet elektrik apo jo elektrik, si dhe kërkesat tjera në ANEKS 7. Kërkohe nga Autoriteti Kontraktues – Departamenti I Prokurimit që të bënë korigjimin

e procedures dhe këto pajisje të largohen nga Aneks 7 dhe të ipet mundësia edhe OE tjerë ekonomik që nuk posedojn Furgon elektrik sepse është I panevojshëm dhe është diskriminues dhe favorizues".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur si vijon: Lidhur me pretendimet ankimore rreth vlerës së parashikuar, të shprehura, vlera e parashikuar është e bazuar në vlerën aktuale të tregut. Njëkohësisht, procedura është e hapur dhe po ashtu kriteri i dhënies së kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Në fazën në të cilën gjendet procedura, është hipotetike të thuhet se vlera e parashikuar është e ulët një gjë e tillë do të vërtetohet pas hapjes së ofertave të mundshme, për të cilat jemi të bindur se vlera është reale dhe e bazuar në tregun aktual të ofrimit të shërbimit të kërkuar. Mbi këtë bazë, pretendimi ankimor është i pabazuar. Si përfundim, AK ka publikuar njoftimin mbi korigjimin e aktivitetit të prokurimit, ku ka vërejtur gabime teknike të shfaqura në dosjen e tenderit. Po ashtu, kriteret janë të vendosura në përputhje të plotë me natyrën e aktivitetit të prokurimit që është publikuar, duke marrë për bazë parimet e prokurimit, nenin 7 për mosdiskriminimin dhe nenin 6 për ekonomikitetin dhe efikasitetin e procedurës.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.04.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.